



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi a) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Noti Construction” Sh.P.K. të datës 11.04.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 29.03.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i Pilotave Betonarme në lagjen Kalabri” me nr. të prokurimit 616-24-1880-5-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pasafatshme kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Noti Construction” Sh.P.K. e datës 11.04.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 29.03.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i Pilotave Betonarme në lagjen Kalabri” me nr. të prokurimit 616-24-1880-5-2-1.
- II. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Noti Construction” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Noti Construction” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 11.04.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 29.03.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i Pilotave Betonarme në lagjen Kalabri” me nr. të prokurimit 616-24-1880-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është parashtruar pas afatit. Përmes nenit 60 par. 1 nënpar. b) është përcaktuar se “Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0)”. Në rastin konkret njoftimi mbi vendimi është nxjerrë me datë 29.03.2024 që nënkupton se kjo është dita zero (0) ndërsa data e fundit kur ka mundur të parashtrohet kërkesë për rishqyrtim ka qenë data 03.04.2024 deri në ora 16:00.

